

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vihet nën kontroll zjarri pranë Parkut Arkeologjik të Apolonisë, Gonxhja: Zjarrvënie e qëllimshme, monum entet të paprekura
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/vihet-nen-kontroll-zjarri-prane-parkut-arkeologjik-te-apo-lonise-gonxh-i401855
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:44:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 18:57:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	184a25d09b32fc8a20f343168796201b3cf7d8243f414de9dc585c99239881e1
TEKSTI	b01fac09025d530dd2d2ff59e30ac215b7f26983eb76f2a4547a10a7a7925ab3
PAMJA	3a4580b09f4f13834ecae8cda17eadf159e8a4806c3e3c8c6b73cb8463e0c8b3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a61e95027bba4e76b1b8fa7569642d5ca75594f8f1c4d6455f71379d33a50839
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a61e95027bba4e76b1b8fa7569642d5ca75594f8f1c4d6455f71379d33a50839>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Aktualitet

22 Shtator 2026, 20:57

Vihet nën kontroll zjarri pranë Parkut Arkeologjik të Apolonisë, Gonxhja: Zjarrvënie e qëllimshme, monumentet të paprekura



Shkruar nga Newsbomb



Blendi Gonxhja

Zjarri që ra pasditen e sotme në zonën përreth Parkut Arkeologjik të Apolonisë është vënë nën kontroll falë ndërhyrjes nga toka dhe ajri.

Në terren ka qenë edhe ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Blendi Gonxhja, i cili ndoqi nga afër operacionin për shuarjen e flakëve. Ai theksoi se mbrojtja e parkut, si një nga pasuritë më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore, mbetet prioritet absolut.

Sipas Gonxhes, zjarri nuk ka lidhje me kushtet atmosferike, pasi temperaturat janë të ulëta, por dyshohet se është i shkaktuar nga dora e njeriut. Policia ka nisur hetimet për zbardhjen e shkaqeve.

"Operacioni për shuarjen e flakëve vazhdon me forca të shtuara. Në temperatura kaq të ulëta një zjarr i tillë nuk ndodh vetvetiu. Bëhet fjalë për gabim njerëzor apo zjarrvënie të qëllimshme. Për fat të mirë, asnjë monument brenda parkut nuk është dëmtuar," deklaroi Gonxhja.

Ministri falenderoi Forcat e Emergjencave Civile, ushtrinë dhe zjarrfikësit për reagimin e shpejtë, si dhe qytetarët që u angazhuan në shuarjen e zjarrit. Ai veçoi shembullin e Andrea Ramës nga Lushnja, një vizitor që konstatoi i pari flakët dhe u bë pjesë e përpjekjeve për t'i neutralizuar.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

"Shteti i gysravel" Sallianji "shpërthen" pas arrestimit të shëfës së SHISH: Qeveria e Ramës ka ulur pantollonat para krimit (REAGIMI)



Politikë

PD mbledh kryesinë në mbrëmje, merret VENDIMI për qëndrimin politik ndaj Ramës pas skandalit me Viora Hysenin

Zbulohet më shumë artikuj >

Gonxhja nënvizoi se pavarësisht se situata me monumentet është e qetë dhe nuk raportohet asnjë dëm në zonën muzeale, shqetësimi mbetet për banesat pranë parkut dhe për masivin e ullinjve dhe pemëve shekullore që i japin vlerë të veçantë kodrës së Apolonisë.

Ndërhyrja në terren vijon për shuarjen e plotë të vatrave të mbetura dhe izolimin e perimetrit, ndërsa pritet që hetimet të përcaktojnë përgjegjësit për zjarrin e dyshuar si të qëllimshëm.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Mërkurë 20:27 Newsbomb

PRANGOSET në Rusi trafikanti i shumëkërkuar i SPAK Shpëtim Aliu, "shoku" i Eldi Dizdarit pritet t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)



Aktualitet

Kryeqyteti pret të dielën "Triathlon", në fundjavë do të ketë bllokime rrugësh, ja cilat zona do të "paralizohen"


🕒 E Mërkurë 19:54



Aktualitet

Aksident i dytë brenda ditës në Durrës, makina përplas qytetarin me skuter elektrik

🕒 E Mërkurë 19:14





E Mërkurë 18:39 Newsbomb

Duraj tha se Bleona Mata është gjallë, nëna "e helmuar" nga deklarata e tij e paralajmëron: Do të ndjek penalisht! Reagon dhe SPAK



Aktualitet

KED lejon tre kandidatë të vazhdojë garën për Gjykatën Kushtetuese, ndalohet vetëm Brunilda Bara

E Mërkurë 17:52



Aktualitet

Parkimi në rrugët e Durrës bëhet me lekë, ja sa do të paguajnë qytetarët

E Mërkurë 17:45



E Mërkurë 17:35 Newsbomb

E RËNDË në Dibër, efektivi i Policisë ndalohet për dhunë fizike ndaj një vajze dhe vëllait të saj të mitur (DETAJE)



Aktualitet

Behgjet Pacolli publikon FOTO me dy miqtë e tij nga Nju Jorku, por puna që ata bëjnë mund ta ndihmojë shumë për Aeroportin e Vlorës

E Mërkurë 17:07



Aktualitet

SPAK zbardh kërkesën: Shëfja e SHISH do të merret në pyetje mesditën e nesërme, dy të tjerët në orën 9 të mëngjesit (DETAJE)

E Mërkurë 16:44 Newsbomb



Aktualitet



🕒 E Mërkurë 15:49 Newsbomb

Sërish zjarr në Vlorë, vatra e tretë për sot, rrezikohet spitali i qytetit dhe banesat, detajet e para



Aktualitet

Nesër seancë plenare, mobilizohen studentët! Paralajmërojnë protestë para Parlamentit, ja "porosia" që i lënë njëri-tjetrit

🕒 E Mërkurë 15:29



Aktualitet

Ky është 50-vjeçari që humbi kontrollin e motorit, u rrëzua dhe vdiq në Lezhë, la pas gruan, dy djem e dy vajza (EMRI-FOTO)

🕒 E Mërkurë 15:30 Newsbomb



🕒 E Mërkurë 15:20

28 thirrje pa përgjigje dhe 25 të refuzuara, Ergys Agasi nuk i hapte telefonin Vlorë Hysenit, SPAK zbardh bisedat në "Signal": Ka dhe telefonata me video



Aktualitet



Aktualitet

Makina merr përpara motoristin në Durrës, drejtuesi merr plagë të rënda trupore, niset me urgjencë për në spital

🕒 E Mërkurë 15:01 Newsbomb

Avokatët përshkallëzojnë bojkotin: Nga e hëna nuk marrin pjesë as në masat e sigurisë në GJKKO

🕒 E Mërkurë 14:54



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.